Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**14.11.2023**	**16.11.2023**	**2023/0875**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.11.2023, **OE "Astraplan SH.P.K."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0875,** kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit **LOT 2** me titull: **LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-te**" me nr. të prokurimit: **"214-23-6442-5-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **LOT 2- 2,288,173.44 €.**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 i LPP-së -Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 2.

Nenin 72 i LPP-së - Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi AK-ja ka bere diskriminimin e kompanisë tone pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat ne Dosjen e Tenderit dhe ne Njoftimin për Kontrate ne te dy LOT-et. AK-ja ka qen e obliguar qe te analizoj kërkesën ne Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne DT dhe ne njoftim për kontratë, pasi qe ne rastin konkret te gjitha i kemi plotësuar, qe bazuar ne trajtimin barabartë te OE-ve konzorciumi jon do duhej te rekomandohej për kontrate ne LOT 2, dmth nëse neve si GOE ishim trajtuar njëjtë sikurse GOE-AC ING SHPK & TOP PROJEKT SHPK & DECON SHPK- (i rekomanduar për kontrate ne LOT1)

Ne dokumentin e dorëzuar me oferte ne platformën e e-prokurimit:

dokumentet me nr:

- *3.1.1 LISTA E KONTRATAVE ASTRAPLAN SHPK* .....2,506,936.20 €
  (2,506,936.20 € me pranime teknike ose referenca)
- 3.1.2 dhe 3.1.3 LISTA E KONTRATAVE U UNIQUE SHPK .....704,330.49 €
  (704,330.49 € me pranime teknike ose referenca)
- 3.1.4 LISTA E KONTRATAVE INET SHPK.....373,240.40 €
  (373,240.40 € me pranime teknike ose referenca)

Totali i realizimit te kontratave për Grupin tone është .....3,584,507.09 €

Nenit 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Autoriteti Kontraktues ka bere vlerësim te ofertave ne kundërshtim me nenin 59 pasi ka anuluar LOT2, edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit, saktësisht Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa

1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pakë së për LOT -1 = 2,500,000.00 €, LOT -2 = 3,000,000.00 €, Në rast së operatori ekonomik dorëzon tender për 2 (Dy) Lote, atëherë shuma totale e projekteve të përfunduara duhet ta tejkaloj shumën e qarkullimit të Lotit me vlerë më të madhe dhe në rast së Operatori Ekonomik dorëzon tender për një pjesë (Lot), atëherë duhet te përmbush qarkullimin e atij Loti.

Kjo është ne kundërshtim te plotë me nenin 59, paragrafin 4, citojmë paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-s

("Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.)

Neni 60 i LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës Autoriteti kontraktues ka bere vlerësim te ofertave ne kundërshtim me nenin 60 e jo ne përputhje me këtë nen duke bere shkelje te këtij neni saktësisht paragrafin 1 i cili thotë: citojmë paragrafin 1 te nenit 60 te LPP-s

("1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është")

Autoriteti Kontraktues ka bere vlerësim te ofertave ne kundërshtim me nenin 60 pasi **ka anuluar LOT2**, edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit, saktësisht Neni 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa

1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pakë së për LOT -1 = 2,500,000.00 €, LOT -2 = 3,000,000.00 €, Në rast së operatori ekonomik dorëzon tender për 2 (Dy) Lote, atëherë shuma totale e projekteve të përfunduara duhet ta tejkaloj shumën e qarkullimit të Lotit me vlerë më të madhe dhe në rast së Operatori Ekonomik dorëzon tender për një pjesë (Lot), atëherë duhet te përmbush qarkullimin e atij Loti.

AK-ja neve si GOE Astraplan & U-Unique shpk & Inet shpk na ka eliminuar ne kundërshtim me LPP□n dhe RRUOPP-n, pasi qe e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te lirë.

• AC ING SHPK & TOP PROJEKT SHPK- është i pa përgjegjshëm për LOT2, sepse tejkalimi i çmimin është me shume se 2% (nuk ka plotësuar formularin e çmimeve sipas kërkesës) si dhe kushti i tenderit është qe një OE ose GOE ka te drejtën te shpallet fitues vetëm për 1 LOT, pasi qe është shpallur fitues ne LOT1, nuk mund te shpallet fitues edhe ne LOT2. Respektivisht ky GOE te trajtohet pale pa interes ne kuptim te nenit 4.1.26 për shkak te mos plotësimit te aspektit administrativ.

• EBK SHPK&PRO ARK CONSTRUCTION SHPK&UNIVERS-MI BUJAR GODENI P.N

Ky GOE është i pa përgjegjshëm pasi qe nuk plotëson kushtet e kërkuara ne Nenin 9.1 & 9.2 te DT□s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, respektivisht ky GOE te trajtohet pale pa interes ne kuptim te nenit 4.1.26 për shkak te mos plotësimit te aspektit administrativ.

• NIKA PRO-ING SHPK & PRO &CO GROUP SHPK -Ky GOE është i pa përgjegjshëm pasi qe nuk plotëson kushtet e kërkuara ne Nenin 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, respektivisht ky GOE te trajtohet pale pa interes ne kuptim te nenit 4.1.26 për shkak te mos plotësimit te aspektit administrativ.

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Prej nga rrjedhimisht ne anulimin e LOT 2 AK-ja ka bere shkelje te nenit 62 te LPP-s Nenin 72 i LPP-së - Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë AK-ja ka shkelur nenin 72, pasi qe nuk ka kërkuar informacione dhe dokumentacione shtese për asnjë nga kontratat qe kemi paraqitur ne listën e dosjes se tenderit.

Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, pasi qe e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët. nga paneli shqyrtues në OSHP kërkojmë që te merret:

V E N D I M I.

APROVOHET si e bazuar ankesa e GOE Astraplan SHPK & U-UNIQUE SH.P.K. & INET SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të, nr. te prokurimit: 214-23-6442-5-1-1.

II. Anulohet njoftimi mbi Vendimin e AK-s MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME për Anulimin e aktivitetit te prokurimit -LOT2, si dhe aktiviteti i Prokurimit: LOT 2 - Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të, nr. te prokurimit: 214-23-6442-5-1-1, kthehet ne RI-VLERESIM

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pakë së për LOT -1 = 2,500,000.00 €, LOT -2 = 3,000,000.00 €, Në rast së operatori ekonomik dorëzon tender për 2 (Dy) Lote, atëherë shuma totale e projekteve të përfunduara duhet ta tejkaloj shumën e qarkullimit të Lotit me vlerë më të madhe dhe në rast së Operatori Ekonomik dorëzon tender për një pjesë (Lot), atëherë duhet te përmbush qarkullimin e atij Loti.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Evidenca 1. Lista e projekteve të përfunduara Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projekte e realizuara, duke bashkëngjitur referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Puneve te Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: "LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të"

Nr. i prokurimit[2]	**214-26-6442-5-1-1**

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertave për Lot 1	Vlera totale e ofertave për Lot 2
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik EBK SH.P.K.; PRO ARK CONSTRUCTION SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI,	1,748,088.00 €	2,070,800.92 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.	1,874,249.86 €	2,182,852.32 €
3	Grup i Operatorëve Ekonomik Astraplan SH.P.K.; U - UNIQUE SH.P.K.; INET SH.P.K.	1,777,777.77 €	2,177,777.77 €
4	Grup i Operatorëve Ekonomik NIKA PrO- Ing SH.P.K.; Pro & Co Group SH.P.K.	1,854,576.19 €	2,168,903.73 €
5	**Grup i Operatorëve Ekonomik AC ing SH.P.K.; TOP PROJEKT SH.P.K.; Decon SH.P.K.**	**1,652,408.34 €**	**1,971,761.80 €**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

1.Ministria e Punëve të Brendshme shpërblen me kontratë **Grup i Operatorëve Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik AC ing SH.P.K.; TOP PROJEKT SH.P.K.; Decon SH.P.K.- për Lot 1 LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-të" vlera totale e ofertës 1,652,408.34 €€**

2 **Ministria e Punëve të Brendshme anulon**[3] aktivitetin e prokurimit *:*
Lot 2 "Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të"

Data: 18/10/2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim ISLAMI

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Astraplan SH.P.K.**

Aktiviteti i prokurimit me titull: "**LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-te dhe LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-te", ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 23.06.2023, procedurë e hapur, kontrata punë, hapja e ofertave është bërë me datë 07.08.2023, njoftimi mbi vendimin e AK-së publikohet me datë 19.10.2023.**

OE ankuesi i pa kënaqur me vendimin e AK-së, si dhe me përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, me datë 05.11.2023 parashtron ankesë në OSHP, kundër anulimit të Aktivitetit të prokurimit si dhe kundër eliminimit të të njëjtit.

Tutje, OE ankuesi pretendon se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit dhe na ka eliminuar si OE duke e shkelë nenet: 7,59,60, 62, 69, 72 të LPP-së si dhe kërkesat 9.1 & 9.2 të DT-së.

Sqarojmë se, AK ka eliminuar OE ankuesin me arsyetimin:

Dëshmia qe NUK keni ofruar:

Ju për ketë kërkesë ne ofertën e tuaj keni prezantuar listat e projekteve te grupit pjesëmarrës ne ketë tender mirëpo listat te cilat keni prezantuar nuk e përmbush kërkesat e dosjes se tenderi dhe njoftim për kontrate. Ne listën e kontratave te prezantuar nga grupi i juaj pas ekzaminimit shihet se vlera e projekteve në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta është 2,231,885.00 € , ndërsa me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate është kërkuar min 3,000,000.00 për pjesëmarrësit ne te dy Lotët.
Projekte tjera te prezantuara ne listën tuaj nuk janë siç është kërkuar ne dosje, por janë projekte ne ndërtim te ulet , disa projekte te pa përfunduara dhe disa projekte janë te natyrës tjetër dhe disa projekte janë te përfunduara, por me te vjetra se tri vite para njoftimit për kontrate, si rrjedhoje kjo kërkesë nuk është plotësuar sipas kërkesave ne DT dhe NJK , andaj bazuar ne *UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.*

OE ankuesi pretendon se e plotëson këtë kriter, dhe se e tejkalon sipas listave të prezentuara;

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues sqaron, në ofertën e të njëjtit gjenden tri lista me projekte: **GOE**: OE Astraplan, OE U-Unique dhe OE Inet SHPK.

-6,406,895.58 euro

-704,330.49 euro

-433,080.22 euro si dhe lista e projekteve të OE inet Shpk e cila nuk mund të merret e mirëqenë për arsye të natyrës së projekteve.

Në listën e Astraplan gjenden projekte të natyrës ndërtim të lartë, renovim, po ashtu edhe tek lista e anëtarit të konzorciumit U-Unique është e bashkangjitur lista e cila posedon projekte të natyrës ndërtim dhe renovim, kurse anëtari i konzorciumit OE Inet Shpk posedon listën e projekteve me projekte të teknologjisë informative, rrjetave, dhe mirëmabajtje.

Mirëpo AK në arsyetimin e eliminimit si dhe në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk potencon se cilat projekte nuk i plotësojnë kriteret dhe cilat mund ti merren të mirëqenë.

Andaj si e tillë pretendimi i OE ankues lidhur me arsyen e eliminimit gjendet pjesërisht i bazuar, e cila gatë procesit të rivlerësimit, kërkohet nga AK që konform nenit 72 të LPP-së të sqaroj listat e projekteve të përfunduara.

Tutje, OE ankuesi ka parashtruar pretendime edhe kundër OE AC Ing SHPK, OE EBK SHPK si dhe OE Nika Pro Ing SHPK.

Pretendimi i OE ankues kundër OE AC Ing SHPK:

• AC ING SHPK & TOP PROJEKT SHPK- është i pa përgjegjshëm për LOT2, sepse tejkalimi i çmimin është me shume se 2% (nuk ka plotësuar formularin e çmimeve sipas kërkesës) si dhe kushti i tenderit

është qe një OE ose GOE ka te drejtën te shpallet fitues vetëm për 1 LOT, pasi qe është shpallur fitues ne LOT1, nuk mund te shpallet fitues edhe ne LOT2. Respektivisht ky GOE te trajtohet pale pa interes ne kuptim te nenit 4.1.26 për shkak te mos plotësimit te aspektit administrativ.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron, lidhur me OE AC Ing Shpk në ofertë ka të bashkangjitur paramasën për lot 2, e cila është përmirësuar me gabime aritmetikore mbi 2%, dhe si e tillë pretendimi **gjendet i bazuar.**

	RIKAPITULIMI I PERGJITHSHEM	SHUMA
A	ARKITEKTURA	701,286.30 €
E	ELEKTRIKA	402,065.82 €
H	HIDROINSTALIMET	27,745.66 €
M	MAKINERIA Page 21	539,886.80 €

1	TOTAL	1,670,984.58 €
2	TVSH- E PERFSHIRE NE ÇMIM	300,777.22 €
3	ÇMIMI TOTAL ME TE GJITHA TAKSAT E APLIKUESHME	1,971,761.80 €

Pretendimi i OE ankues kundër OE EBK SHPK:

• EBK SHPK&PRO ARK CONSTRUCTION SHPK&UNIVERS-MI BUJAR GODENI P.N

Ky GOE është i pa përgjegjshëm pasi qe nuk plotëson kushtet e kërkuara ne Nenin 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, respektivisht ky GOE te trajtohet pale pa interes ne kuptim te nenit 4.1.26 për shkak te mos plotësimit te aspektit administrativ.

Ekspertja shqyrtuse sa i përket pretendimit lidhur me OE EBK SHPK sqaron, në e-prokurim gjendet oferta e OE në fjalë, dhe AK ka eliminuar të njëjtin për disa arsye të cilat do ti shqyrtojmë në ankesën e tij të parashtruar me nr. 0876/2023. Kurse lidhur me pretendimet të OE ankuesit të cilat nuk janë të argumentuara dhe të specifikuara konkretisht, nuk mundemi ti shqyrtojmë, si e tillë ky pretendim nuk gjendet i qëndrueshëm.

Pretendimi i OE ankues kundër OE Nika Pro-ingSHPK:

• NIKA PRO-ING SHPK & PRO &CO GROUP SHPK -Ky GOE është i pa përgjegjshëm pasi qe nuk plotëson kushtet e kërkuara ne Nenin 9.1 & 9.2 te DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, respektivisht ky GOE te trajtohet pale pa interes ne kuptim te nenit 4.1.26 për shkak te mos plotësimit te aspektit administrativ.

Pretendimi i OE ankues kundër OE Nika Pro-ing SHPK:

Ekspertja shqyrtuse sa i përket pretendimit lidhur me OE Nika Pro-ing SHPK sqaron, pretendimi i OE ankues nuk qëndron, për faktin se nuk ka parashtruar pretendime konkrete dhe të argumentuara, në mënyrë që ti shtjellojmë.

Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, aktiviteti i prokurimit **LOT 2** konsideroj se duhet të kthehet në rivlerësim, për faktin se AK nuk ka sqaruar ofertat konform nenit 72 të LPP-së, po ashtu nuk ka argumentuar saktësisht arsyet e eliminimit, andaj rekomandoj AK-në që të rivlerësoj ofertat konform LPP-së, Udhëzuesit 001/2023 për PP si dhe rregullorja nr.001/2022 për PP.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Astraplan SH.P.K.**

Blerina Huruglica